



REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI I KONKURENCËS

NJOFTIM PËR MEDIAT

5 DHJETORI - DITA NDËRKOMBËTARE E KONKURENCËS - NDIKIMI NEGATIV I KARTELEVE TEK SHTRESAT E VARFËRA

Mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive është një nga kushtet kryesore për të pasur një ekonomi tregu funksionale. Në datë 5 Dhjetor, komuniteti ndërkombëtar i konkurrencës kujton Ditën Ndërkombëtare të Konkurrencës. Këtë vit kjo ditë ka në fokusin e saj ndikimin negativ të karteleve (marrëveshjeve të ndaluara) tek shtresat e varfëra.

Qëllimi i kësaj ditë është që të rrisë ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve dhe faktorëve që ndikojnë mbi konkurrencën e lirë për marrjen e masave për të mbrojtur konsumatorët nga marrëveshjet e ndaluara në treg, efektet e te cilave ndikojnë ndjeshëm në shtresën e varfër.

Në këtë kuadër, Autoriteti i Konkurrencës kërkon të sensibilizojë biznesin, autoritetet e ndryshme publike dhe veçanërisht gjykatat, për rëndësinë e luftës ndaj marrëveshjeve të ndaluara. Këto marrëveshje kanë një ndikim të drejtpërdrejtë mbi jetesën e më të varfërve në çdo shoqëri dhe përbëjnë një pengesë për qeveritë e vendeve të ndryshme për të siguruar mbrojtjen e këtyre shtresave të shoqërisë. Është llogaritur se ndërmarrjet pjesëmarrëse në marrëveshje të ndaluara përfitojnë miliarda dollarë në kurriz të ndërmarrjeve të tjera, taksapaguesve dhe konsumatorëve në përgjithësi.

Veçanërisht të ndjeshme për shtresat e varfëra të shoqërisë janë marrëveshjet e ndaluara në ushqimet dhe shërbimet bazë. Psh. Autoriteti i Konkurrencës ka ndaluar dhe parandaluar në disa raste marrëveshjet e ndaluara në tregun e prodhimit të bukës, të cilat në disa raste kishin çuar në një rritje të çmimit me rreth 40%. Gjatë vitit 2013, Autoriteti i Konkurrencës, ka hetuar e gjobitur gjithashtu ndërmarrjet e transportit rrugor qytetës në Tiranë, të cilat me marrëveshje ndërmjet kanë kufizuar tregtimin e aboneve të studentit duke rritur koston dy herë më shumë për këto shërbime.

Kultura e konkurrencës mbetet në nivele të ulëta në shumë vende të botës dhe konsumatorët kanë njohuri të kufizuara mbi efektet e dëmshme të karteleve. Në këtë mënyrë Dita Ndërkombëtare e Konkurrencës, ka si synim nxitjen e diskutimeve mbi përfitimet që sjell konkurrenca për konsumatorët dhe

veçanërisht për shtresat në nevojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Kështu synohet që të nxitet kultura e konkurrencës dhe mbështetja e publikut për luftën kundër marrëveshjeve të ndaluara.

5 Dhjetori është caktuar si Dita Ndërkombëtare e Konkurrencës, për shkak se në këtë datë, në vitin 1980, është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, “Seti shumëpalësh i parimeve dhe rregullave të mbi kontrollin e praktikave kufizuese të biznesit”

*Për më shumë informacion për Autoritetin e Konkurrencës dhe Ditën Ndërkombëtare të Konkurrencës vizitoni faqet : www.caa.gov.al
www.incsoc.net/World_Competition_Day.htm dhe
<http://www.facebook.com/worldcompetitionday>*